



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 696/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Fjolla Graiçevci kandidate për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Fjolla Graiçevci kandidate për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 14:40, ka pranuar një ankesë nga Fjolla Graiçevci kandidate për kuvendin komunal në Fushë Kosovë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Fushë Kosovë e cila pretendon se kanë ndodhur disa parregullsi sa i përket numërimit të votave në komunën e Fushë Kosovës duke kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet 0901E/08R, 0915E/01D, 0901X/02R, 0913E/01R. 0903E/01R.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i ankesës nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .
Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë është e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.696/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gylfene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.